

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

Nr. i Prot. 533
Broj Prot. 533
Prot. No. 533
Data: 16.01.26
Datum: 16.01.26
Dite: 16.01.26

Nr. i Pag. 3
Br. Stranica 3
No. Pages 3

PRISHTINË / A No. 2



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Zivotne Sredine, Prostornog planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

DATE/A:	12.01.2026
REFERENC-Ë:	034/411
PËR/ZA/TO:	Shoqatat e operatorëve të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Izedin Bytyqi, U.D. Sekretar i Përgjithshëm
NGA/OD/FROM:	z. Xhemë VESELI Drejtore i Departamentit të Transportit Tokësor
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	L A J M Ë R I M

Lajmërohen të gjithë operatorët e transportit ndër-urban të licencuar nga MMPHI-ja, se bazuar në Ligjin për transportin rrugor Nr.04/L-179, Udhëzimin Administrativ nr.09/2013 për Rrjetin e Linjave dhe Rendin e Udhëtimit në Transportin Ndërrurban të Udhëtarëve me Autobus dhe Udhëzimin Administrativ nr.06/2016 për plotësimin dhe ndryshimin U.A nr.09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit në transportin ndërurban të udhëtarëve me autobus, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës do të bëjë vërtetimin dhe vazhdimin e rendëve të udhëtimit për 3 vitet.

I tërë dokumentacioni për aplikim dhe informacionet e nevojshme mund të merren në zyrën e MMPHI-së (ish ndërtesa e Gërmisë zyra nr. C- 108. ose në numërat e tel: 038/211-547 ose 038/212-100; 038-213-394.

Afati për aplikim është prej datës 12.01.2026 deri me datën 13.02.2026.

Me respekt!

Kriterët për vërtetimin dhe vazhdimin e rendit të udhëtimit për vitin kalendarik 2026 sipas U.A. 09/2013 dhe U.A. 06/2016.

Operatori i transportit duhet të ketë :

1. Aplikacionin dhe Fletëpagesën.
2. Licencë valide për transport publik të udhëtarve të lëshuar nga MMPHI-ja (C ose D) për të cilën nuk është inicuar ndonjë procedurë e pezullimit apo revokimit.
3. Dëshminë për kompetencën profesionale për menaxher (CPC), ku menaxheri i operatorit të transportit nuk mund të paraqitet si shofer për vazhdimin dhe vërtetimin e rendit të udhëtimit.
4. Dëshminë për kapacitetet përkatëse të autobusëve të destinimit ndër-urban të certifikuar nga MMPHI-ja sipas licencës "C" apo "D" (librezat e qarkullimit të autobusave të noterizuara, kartoni teknik/gjashtëmujor të noterizuara dhe sigurimi i autobusit kopje);
5. Dëshminë për numrin e shoferëve të punësuar,
 - 5.1.Për relacionin deri në 50 km. Së paku një (1) shofer për tri(3) rende të udhëtimit.
 - 5.2.Për relacionin mbi 50 km. Së paku një (1) shofer për dy (2) rende të udhëtimit.
6. Tri kopje të rendit të udhëtimit sipas formës dhe përmbajtjes së aprovuar nga Ministria.
7. Vërtetimin (jo më të vjetër se 30 ditë) e organeve kompetente për kontributet e të punësuarve/vërtetimi tatimor, kontrata e punës origjinal dhe patenteshoferi kopje, për të punësuarit dhe menaxherin.
8. Rendin e udhëtimit në origjinal të vitit paraprak, të vërtetuar nga Ministria, për të cilin nuk është inicuar procedurë e revokimit.
9. Dëshminë (raportin e KM dhe udhëtarëve për vitet: 2023; 2024; 2025) konform nenit 30 paragrafi 6 i Ligjit nr.04/L-179 për transportin rrugor
10. Të gjithë operatorët e transportit të cilët nuk aplikojnë brenda afatit të caktuar, konsiderohet që kanë hequr dorë nga rendi i udhëtimit.

Vërejtje:

Dokumentacioni duhet të jetë në origjinal ose kopje e noterizuar dhe dorëzohet në Arkivin e MMPHI-së, përjashtim bënë dokumentacioni i lëshuar nga MMPHI-ja dhe i cili mund të vërtetohet në evidencat zyrtare të DTT-se.





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit ,Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Zivotne Sredine, Prostornog planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment , Spatial Planning and Infrastructure

A p l i k i m i Nr: _____
për vazhdimin dhe vërtetimin e rendit të udhëtimit (RU) 2026

Operatori : _____, me Lic.....dhe nr. _____

Regjioni _____

Fletëpagesën për çdo nisje: dhjetë 10 Euro.

Relacioni: _____

Nisja: / ____ / / ____ / / ____ / / ____ / / ____ /

Kthimi: / ____ / / ____ / / ____ / / ____ / / ____ /

Kilometrat e kaluara për vitin paraprak 2023, 2024, 2025 _____ dhe

Numrin e udhëtarëve të bartur në transportin ndër-urban. _____

Emri dhe mbiemri i menaxherit,

nr. i tel.

Vula dhe nënshkrimi

Vërejtje:

Për të dhëna jo të sakta përgjigjet menaxheri i Operatorit Transportus.